



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Përshëndetje z. Tase,

Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 22.08.2023, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkonti informacion në lidhje me monitorimin e sjelljes së administratës shtetërore në zgjedhjet vendore 2023, ju informojmë se:

Në lidhje me pikën 1, *“Statistikat mbi numrin e punonjësve pjesë e administratës shtetërore nën monitorimin e DAP në vitin 2022 dhe aktualisht në vitin 2023. Departamenti i Administratës Publike është njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, ku përfshihen aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit. Të dhëna 3 apo 6 mujore mund të jenë më të vlefshme.”*, ju informojmë se ky është një informacion që disponohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si institucion që menaxhon buxhetin vjetor në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me pikën 2, *” A janë konstatuar ndryshime në organikën e institucioneve publike apo enteve publike të monitoruara nga ju, të cilat bien ndesh me kufizimet e Kodit Zgjedhor në lidhje me ndalimin e punësimeve, pushimeve nga puna, kontratave të përkohshme ose afatshkurtra të punësimit nga data 13 janar - 13 maj 2023 ?”*, fillimisht dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj kuadrin rregullator që përcakton procedurën e përgatitjes dhe të miratimit të strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore, që përbëhet nga:

1. Ligji 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
2. Ligji 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
3. Vendimi nr.893, datë 17.12.2014, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, të ndryshuar.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 21 të ligjit nr. 90/2012, si dhe të pikës 31 të Vendimit të nr.893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, organizimi i brendshëm i ministrive dhe institucioneve të varësisë, miratohet me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të marrë nga ministri përgjegjës dhe pas marrjes së mendimit të ministrit përgjegjës për financat. Departamenti i Administratës Publike shqyrton dhe harton projekturdrin dhe ia dërgon për

miratim Kryeministrit, në përputhje me numrin e punonjësve të miratuar në ligjin vjetor buxhetor për institucionet e administratës shtetërore.

Pra, Departamenti i Administratës Publike shqyrton dhe përgatit projekturdrat për miratimin e strukturës dhe organikës së ministrive dhe institucioneve të varësisë, përfshirë dhe degët e tyre territoriale dhe ia dërgon për shqyrtim dhe miratim Kryeministrit.

Në këtë kuadër lidhur me kërkesën tuaj për informacion në lidhje me ndryshimet në organikën e institucioneve publike apo enteve publike sqarojmë se, për periudhën e fushatës zgjedhore sipas përcaktimit në:

1. pikën 1, të nenit 77 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë: “Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve” si dhe;
2. shkronjën d, të pikës 1.3 të vendimit nr.9 datë 24.12.2020 të KQZ, ku një ndër veprimtaritë e ndaluara është dhe “gjatë fushatës zgjedhore...shtesat në organikën e çdo institucioni shtetëror...” sqarojmë se:

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore nuk është miratuar asnjë urdhër për miratimin e strukturës dhe organikës, pra nuk ka pasur asnjë ndryshim në organikën e ministrive të linjës/institucioneve të varësisë, për të cilat DAP ka në kompetencë përgatitjen e strukturës dhe të organikës.

Në lidhje me pikën 3, “*Sa është numri i nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të administratës shtetërore, që kandiduan në zgjedhje dhe kërkuan pezullimin nga detyra?*”, fillimisht ju sqarojmë se mbështetur në nenin 4, pika 1, gërma “F”, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike (DAP) është njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil Referuar përcaktimeve të nenit 4 të ligjit të sipërcituar “institucion i administratës shtetërore” konsiderohet aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit.

Nga të dhënat që administrojmë rezulton se numri i nëpunësve të pezulluar për zgjedhjet vendore të vitit 2023, është 7 pezullime nga shërbimi civil për shkak të ligjit (kandidatë për anëtar Këshilli Bashkiak dhe për Kryetar Bashkie), në respektim të parashikimeve të gërmës “d”, pika 1, e nenit 54, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 124, datë 17.2.2016 “Për pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, i ndryshuar,

Referuar pyetjes së dytë, pika 3, “*A ka patur raste të konstatuara kur ky detyrim nuk është respektuar dhe a është marrë masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të tyre nga eprori?*”, ju informojmë se nuk rezulton të ketë patur raste të tilla.

Faleminderit për mirëkuptimin.